



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
REKTORATI

Nr. 1286 prot

Korçë, më 11 / 09 / 2020

VENDIM

Nr. 412, datë 11.09.2020

PËR

PROCEDURAT E RIFILLIMIT TË STUDIMEVE DHE SHLYERJES SË
PROVIMEVE PËR SEZONIN SHTATOR – TETOR 2020

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 90, pika 1, në Statutin e Universitetit, neni 62, në “Rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e Universitetit “Fan S. Noli”, neni 78 dhe neni 106, si dhe mbështetur në vendimin e Rektoratit nr. 598, dt. 07.11.2019, “Për studentët përsëritës në “Master Profesional” me 90 kredite”, Rektorati në mbledhjen e datës 03.09.2020,

VENDOSI:

1. Studentët e regjistruar para vitit akademik 2015-2016 dhe që kanë ndërprerë studimet para këtij viti akademik, kanë të drejtë t'i rifillojnë studimet në të njëjtat programe studimi. Ekuivalentimi i lëndëve të tyre bëhet sipas kurrikulave aktuale. Këta studentë i nënshtorhen kohëzgjatjes së studimeve të përcaktuar në ligjin nr. 80/2015, neni 90, duke filluar nga viti akademik kur rifillojnë studimet.
2. Studentët e regjistruar para vitit akademik 2015-2016, që kanë ndërprerë studimet para këtij viti akademik, por që i kanë rifilluar ato në të njëjtin program pas vitit akademik 2015-2016 i nënshtorhen kohëzgjatjes së studimeve të përcaktuar në ligjin 80/2015, neni 90.

3. Studentët e regjistruar në vitin akademik 2019-2020, që ende nuk kanë kryer pagesën e tarifës së studimit për këtë vit akademik duhet të kryejnë ato nga data 14.9.2020 deri në 18.9.2020. Në rast të kundert, nuk do të mundën të prenotohen në asnjërin prej sezoneve të provimeve të muajit tetor 2020.
4. Pedagogët duhet të vendosin në sistemin dixhital të vlerësimit, në të gjitha ciklet e studimit ku ata japin mësim, frekuentimet e studentëve nga data 14.9.2020 deri në datën 18.9.2020. Kjo procedurë vlen vetëm për lëndët e semestrit të dytë. Nëse kjo procedurë nuk kryhet në këtë periudhë nga pedagogët, studentët nuk do të mund të prenotohen në provimet përkatëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello

